



УПРАВА ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - DREJTORIA PËR MJEDIS JETËSOR
СЕКТОР ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - SEKTORI PËR MJEDIS JETËSOR

Арх. Бр. 11-1215/

Дата: _____ год.

ДО: АД "ЕЛЕКТРАНИ НА СЕВЕРНА
МАКЕДОНИЈА"

ул. "11 Октомври" бр. 9

1000 Скопје

Nr.Arh. 11-1215/

Дата: _____ viti

DERI TE: SHA "ELEKTRANAT E MAQEDONISË SË
VERIUT"

rr. "11 Tetori" nr. 9

1000 Shkup

ПРЕДМЕТ: Доставување на Решение

LËNDA: Dorëzimi i Aktvendimit

ВРСКА: Ваш број 08-1577/1 од 07.03.2025

LIDHJA: Numri juaj 08-1577/1 nga 07.03.2025

Почитувани,

Të nderuar,

Во прилог Ви го доставуваме Решението за издавање на согласност на Студија за оцена на влијанието врз животната средина за проект - Експлоатација на јаглен од наоѓалиштето во Живојно со површинска технологија во општина Новаци, за потребите на инвеститорот АД "ЕЛЕКТРАНИ НА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА" од Скопје.

Krahas kësaj shkrese ju dorëzojm Aktvendimin për dhënien e Pëlqimit të Studimit për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor për projektin - Eksploatacion i thëngjillit nga vendburimi në Zhivojno me teknologji sipërfaqësore në komunën e Novacit, për nevoja të investitorit SHA "ELEKTRANAT E MAQEDONISË SË VERIUT" nga Shkupi.

МИНИСТЕР/MINISTËR

Izet Mexhiti



Изработил/Përpiloi: Влатко Цветаноски, советник *[Signature]*

Контролирал/Kontrollloi: Александар Петковски, помошник
раководител на сектор *[Signature]*

Согласен/Miratoi: Билјана Петкоска,
Раководител на сектор *[Signature]*

Управа за животна средина


Директор

Игор Никоски

Кабинет на министер / Kabineti i ministrit

Согласен / Me pëlqim të:

Husamet Agushovski *[Signature]*





УПРАВА ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - DREJTORIA PËR MJEDIS JETËSOR
СЕКТОР ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - SEKTORI PËR MJEDIS JETËSOR

Врз основа на член 24 став 7 од Законот за животна средина (Службен весник на Република Македонија бр. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 187/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 99/2018 и Службен весник на Република Северна Македонија бр. 89/2022 и 171/2022), Министерот за животна средина и просторно планирање донесе

Në bazë të nenit 24 paragrafi 7 të Ligjit për Mjedisin Jetësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/05, 81/05, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 187/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 99/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 89/2022 dhe 171/2022) ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor merr këtë

РЕШЕНИЕ

1. Со ова Решение се дава Согласност на барањето за спроведување на проектот - Експлоатација на јаглен од наоѓалиштето во Живојно со површинска технологија во општина Новаци, за потребите на инвеститорот АД "ЕЛЕКТРАНИ НА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА" од Скопје.
2. Студијата за оцена на влијанијата врз животната средина на проектот - Експлоатација на јаглен од наоѓалиштето во Живојно со површинска технологија во општина Новаци, ги задоволува барањата за заштита на животната средина со примена на мерките за спречување и за намалување на штетните влијанија врз животната средина, со задолжување до инвеститорот децидно да ја имплементира Планот за управување со животната средина и социјалните аспекти и мониторинг планот.

AKTVENDIM

1. Me këtë Aktvendim jepet Pëlqimi për kërkesën për realizimin e projektit - Eksploatacion i thëngjillit nga vendburimi në Zhivojno me teknologji sipërfaqësore në komunën e Novacit, për nevoja të investitorit SHA "ELEKTRANAT E MAQEDONISË SË VERIUT" nga Shkupi.
2. Studimi për vlerësimin e ndikimeve mjedisore të projektit - Eksploatacion i thëngjillit nga vendburimi në Zhivojno me teknologji sipërfaqësore në komunën e Novacit, plotëson kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, me zbatimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis, duke detyruar investitorin që ta implementojë në mënyrë të qartë Planin për menaxhimin e mjedisit jetësor dhe aspekteve sociale si dhe planin i monitorimit.

УПРАВА ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - DREJTORIA PËR MJEDIS JETËSOR
СЕКТОР ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - SEKTORI PËR MJEDIS JETËSOR

3. Ова Решение влегува во сила со денот на донесувањето, а ќе се објави во рок од пет работни дена од денот на донесувањето во најмалку еден дневен весник достапен на целата територија на Република Северна Македонија, на интернет страницата, како и на огласната табла во Министерството за животна средина и просторно планирање.

3. Ky Aktvendim hyn në fuqi nga dita e miratimit dhe do të publikohet brenda pesë ditëve pune nga data e miratimit në të paktën një gazetë të përditshme të disponueshme në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në faqen e internetit, si dhe në tabelën e shpalljeve në Ministrinë për Mjedisin Jetësor dhe Planifikimin Hapësinor.

Образложение

Инвеститорот АД “ЕЛЕКТРАНИ НА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА” од Скопје, со седиште на ул. “11 Октомври” бр. 9 од Скопје до Министерството за животна средина и просторно планирање достави Студија за оцена на влијанието врз животната средина за проект - Експлоатација на јаглен од наоѓалиштето во Живојно со површинска технологија во општина Новаци, изработена од страна на “ТЕХНОЛАБ” ДОО од Скопје со одговорно лице за изготвување на студијата за оцена на влијание врз животната средина М-р Магдалена Трајковска Трпевска - експерт за оцена на влијанието на проектите врз животната средина, за потребите на инвеститорот АД “ЕЛЕКТРАНИ НА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА” од Скопје. Целта на проектот е отварање на рудник за експлоатација на јаглен од наоѓалиштето во Живојно со површинска технологија во општина Новаци. Експлоатационото поле зафаќа површина од околу 7 km². Јагленот кој ќе се ископува од наоѓалиштето во Живојно заедно со јагленот од ПК Суводол и ПК Брод Гнеотино ќе биде наменет за снабдување на Термоелектраната Битола како би се обезбедила непречена работа на оваа

Arsyetim

Investitori SHA “ELEKTRANAT E MAQEDONISË SË VERIUT” nga Shkupi me seli në rrugën “11 Tetori” nr. 9 nga Shkup, ka dorëzuar tek Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor një Studim për vlerësimin e ndikimeve mjedisore për projektin – Eksplorimi i qymyrit nga vendburimi “Zhivojno” me teknologji sipërfaqësore në komunën e Novacit, i realizuar nga “TEHNOLAB” SHPK nga Shkupi me person përgjegjës për hartimin e studimit për vlerësimin e ndikimeve mjedisore, Mr. Magdalena Trajkovska Trpevska - ekspert për vlerësimin e ndikimit të projekteve në mjedis, për nevojat e investitorit SHA “ELEKTRANAT E MAQEDONISË SË VERIUT” nga Shkupi. Qëllimi i projektit është hapja e një miniere për shfrytëzimin e qymyrit nga vendburimi “Zhivojno” duke përdorur teknologji sipërfaqësore në komunën e Novacit. Fusha e shfrytëzimit mbulon një sipërfaqe prej afërsisht 7 km². Qymyri që do të nxirret nga vendburimi “Zhivojno”, së bashku me qymyrin nga minierat e qymyrit Suvodol dhe Brod Gneotino, do të jenë të destinuar për furnizim në Termocentralin e Manastirit me qëllim sigurimin e



**УПРАВА ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - DREJTORIA PËR MJEDIS JETËSOR
СЕКТОР ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - SEKTORI PËR MJEDIS JETËSOR**

термоелектрана. Вкупните експлоатациони резерви се пресметани во количина од околу 23,6 милиони тони. Се очекува експлоатацијата на наведените експлоатациони резерви да биде завршена за околу 14 години.

Во Студијата анализирани се можните влијанија во фаза на изградба и оперативна фаза како: воздух, вода, почва, бучава, вибрации, биодиверзитет, климатски промени, предел и визуелни ефекти, социјални елементи на животната средина, културно наследство и кумулативни влијанија. Аналогно на анализираниите можни влијанија врз животната средина, предвидени се мерки за спречување и ублажување на негативните влијанија во фаза на проектирање, изградба, оперативна фаза, престанок со работа во глава 7, Анализа на ризици и план на мерки за непредвидени незгоди во глава 8 и План за управување со животната средина и социјалните аспекти и мониторинг план во глава 9 кои според наша оцена се соодветни и апликативни.

Согласно член 91 од Законот за животна средина (Службен весник на Република Македонија бр. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 187/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 99/2018 и Службен весник на Република Северна Македонија бр. 89/2022 и 171/2022) се одржа Јавна расправа по Студијата за оцена на влијанието врз животната средина за проектот - Експлоатација на јаглен од наоѓалиштето во Живојно со површинска технологија во општина Новаци, на ден 12.05.2025 година (понеделник) во големата сала во општина Новаци со почеток во 11:30 часот.

funkcionimit të pandërprerë të këtij termocentrali. Rezervat totale të shfrytëzueshme llogariten në afërsisht 23.6 milionë ton. Shfrytëzimi i rezervave të shfrytëzimit të lartpërmendura pritet të përfundojë përafërsisht në 14 vjet.

Studimi analizoi ndikimet e mundshme gjatë fazave të ndërtimit dhe operimit, të tilla si: ajri, uji, toka, zhurma, dridhjet, biodiversiteti, ndryshimet klimatike, efektet peizazhore dhe vizuale, elementët socialë të mjedisit, trashëgimia kulturore dhe ndikimet kumulative. Analogisht me ndikimet e mundshme mjedisore të analizuara, parashikohen masa për të parandaluar dhe zbutur ndikimet negative gjatë fazave të projektimit, ndërtimit, fazës operative dhe përfundimit të punës në Kapitullin 7, Analizën e Rrezikut dhe Planin e Emergjencës në Kapitullin 8, dhe Planin për menaxhimin e mjedisit jetësor dhe aspekteve sociale si dhe plani i monitorimit në Kapitullin 9, të cilët sipas vlerësimit tonë janë të përshtatshëm dhe të zbatueshëm.

Sipas nenit 91 të Ligjit për Mjedisin Jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 187/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 99/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 89/2022 dhe 171/2022), u mbajt një diskutim publik mbi Studimin për vlerësimin e ndikimeve mjedisore për projektin - Eksplorimi i qymyrit nga vendburimi "Zhivojno" me teknologji sipërfaqësore në komunën e Novacit, më 12.05.2025 (e hënë) në sallën e madhe të komunës së Novacit, duke filluar nga ora 11:30.



УПРАВА ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - DREJTORIA PËR MJEDIS JETËSOR
СЕКТОР ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - SEKTORI PËR MJEDIS JETËSOR

Комисијата за изработка на Извештајот за соодветноста на Студијата за оцена на влијанијата врз животната средина за проектот – Експлоатација на јаглен од наоѓалиштето во Живојно со површинска технологија во општина Новаци, формирана од Министерот за животна средина и просторно планирање, по спроведената јавна расправа, согласно Правилникот за формата, содржината, постапката и начинот за изработка на извештајот за соодветноста на Студијата за оцена на влијанието на проектот врз животната средина (“Службен весник на Република Македонија” бр. 33/2006) го изработи Извештајот и го достави до Министерот за животна средина и просторно планирање. Комисијата за изработка на Извештајот за соодветноста на Студијата за оцена на влијанието врз животната средина за проектот – Експлоатација на јаглен од наоѓалиштето во Живојно со површинска технологија во општина Новаци ги разгледа изворите и видовите на можни деградации и загадувања врз основа на што се димензионирани и дефинирани мерките за заштита на основните медиуми на животната средина. Проектираните заштитни мерки за спречување и намалување на влијанијата врз животната средина се апликативни и ќе ги задоволат основните барања. Извештајот за соодветноста на Студијата за оцена на влијанијата врз животната средина беше објавен во дневен весник достапен на целата територија на Република Северна Македонија и на интернет страницата на Министерството за животна средина и просторно планирање.

Komisioni për përgatitjen e Raportit për përshtatshmërinë e Studimit për vlerësimin e ndikimeve mjedisore për projektin – Eksplorimi i qymyrit nga vendburimi “Zhivojno” me teknologji sipërfaqësore në komunën e Novacit , i formuar nga Ministri për Mjedisin Jetësor dhe Planifikimin Hapësinor, pas zhvillimit të diskutimit publik, sipas Rregullores për format, përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e përgatitjes së raportit për përshtatshmërinë e Studimit për vlerësimin e ndikimeve të projektit në mjedis (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 33/2006) ka përgatitur Raportin dhe e ka dorëzuar te Ministri e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Komisioni ka shqyrtuar burimet dhe llojet e mundshme të degradimeve dhe ndotjeve dhe ka dimensionuar dhe përcaktuar masat për mbrojtjen e mjedisit për projektin - Eksplorimi i qymyrit nga vendburimi “Zhivojno” me teknologji sipërfaqësore në komunën e Novacit. Shqyrtuan burimet dhe llojet e degradimeve dhe ndotjeve të mundshme, në bazë të të cilave janë dimensionuar dhe përcaktuar masat për mbrojtjen e mediave themelore mjedisore. Masat mbrojtëse të projektuara për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve mjedisore janë të zbatueshme dhe do të plotësojnë kërkesat themelore. Raporti për përshtatshmërinë e Studimit për vlerësimin e ndikimeve mjedisore është botuar në një gazetë të përditshme të disponueshme në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

УПРАВА ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - DREJTORIA PËR MJEDIS JETËSOR
СЕКТОР ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА - SEKTORI PËR MJEDIS JETËSOR

Врз основа на горенаведеното го одлучи
како во диспозитивот на ова Решение.

Правна поука: Против ова Решение
инвеститорот, засегнатите правни или
физички лица, како и здруженијата на
граѓани формирани за заштита и за
унапредување на животната средина,
можат да поднесат жалба до Државна
комисија за одлучување во управна
постапка и постапка од работен однос во
втор степен, во рок од 15 (петнаесет дена) од
денот на последното направено објавување
на решението согласно член 90 став (1) точка
5 од Законот за животна средина.

Со почит,

Në bazë të përshkrimit të mësipërm,
vendoset si në pjesën dispozitive të këtij
Aktvendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij
aktvendimi, investitori, personat juridikë
ose fizikë të prekur, si dhe shoqatat e
qytetarëve të formuara për mbrojtjen dhe
përmirësimin e mjedisit, mund të paraqesin
ankesë në Komisionin Shtetëror për
vendim marrje në procedurë administrative
dhe procedurë të marrëdhënieve të punës
në shkallën e dytë, brenda një periudhe prej
15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e
shpalljes së fundit të vendimit, në përputhje
me nenin 90, paragrafi (1), pika 5 e Ligjit për
Mjedisin Jetësor.

Me respekt,

МИНИСТЕР/MINISTËR

Izet Mexhiti



Изработил/Përpiloi: Влатко Цветаноски, советник *[Signature]*
Контролирал/Kontrollor: Александар Петковски, помошник
раководител на сектор *[Signature]*
Согласен/Miratoi: Билјана Петкоска,
Раководител на сектор *[Signature]*

Управа за животна средина
Директор
Игор Никоски *[Signature]*

Кабинет на министер / Kabineti i ministrit
Согласен / Me pëlqim të:
Husamet Agushovski *[Signature]*

